

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Maran, trajneri italian i Kombëtares tregon jetën e tij shqiptare: Ndihem si në shtëpi
ADRESA	https://piranjat.al/sport/maran-trajneri-italian-i-kombetares-tregon-jeten-e-tij-shqiptare-ndihem-si-i104027
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 12:12:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 12:01:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	14580ae0d0104023037b3d4f3ac8adada941cef925a97087ae72e41a15ba2537
TEKSTI	f96a505e3d213e1601a63dcf8a66b84bcee677d997e94bcc65b597f22ad6f463
PAMJA	a47744ec4d345c7d4e997d27d1ab3e1bdfef115f9c4f45f46e60aa8a7433b2aed

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	846a91b2905d18889c11f07d56750c6f39f1ca4691b88792ba484f036c72f334
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	47dca60bb12c3dc439ebb43dab156a56f0c4323b738cbf9a7b5f92b8b605451e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/846a91b2905d18889c11f07d56750c6f39f1ca4691b88792ba484f036c72f334

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash: [the ydaje](#) vdekje përmes një mesazhi ■ [armesh, Berisha: Familia e](#) deklaratat bombë të ish-zëvendëskryeministrit ■ [deputetes Zegjine Çaushti](#) deputetja Çaushti, pasi Bledar Bakaj dëshohet se ■ [shpejt çështjen e presidentit](#) dhe drejtuesve politikë që ■ [Libasan 18-vjecari](#)

SPORT

Maran, trajneri italian i Kombëtares tregon jetën e tij shqiptare: Ndihem si në shtëpi

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 14:01



Nga rutina e mëngjesit dhe dashuria për natyrën, te familja, miqtë dhe ditët e lira; nga përshtypjet për Shqipërinë dhe mikpritjen shqiptare, te tava e dheut, "avash-avash" dhe vështirësitë me fjalën "përsëndetje".

Trajneri i Kombëtares shqiptare, Rolando Maran, rrëfen në një intervistë për fshf.org anën e tij më personale, duke folur për jetën e përditshme dhe muajt e parë në Shqipëri.

Maran tregon çfarë e pëlqen më shumë në punën e tij, si e kalon një ditë perfekte kur është i lirë, çfarë e ka impresionuar më shumë te shqiptarët dhe cilat janë vlerat që dëshiron t'ua përcjellë edhe futbollistëve të Kombëtares. Një bisedë ndryshe me trajnerin kuqezi, mes futbollit, jetës, natyrës dhe disa fjalëve të para në shqip.

- Në çfarë ore zgjohesh zakonisht?

- Herët, zakonisht rreth orës 7, ndoshta edhe më herët, por ky është orari i zakonshëm në të cilin zgjohem.

- Cila është gjëja e parë që bën në mëngjes?

- Kjo është e thjeshtë. Gjëja e parë që kërkoj është një hapësirë të jashtme, çfarëdo qoftë ajo. Ose hap një dritare, dal në terracë apo në kopsht, por gjëja e parë që bëj është të dal në një ambient të hapur.

- Në çfarë ore vjen në Federatë?

- Menjëherë pas kësaj. Nuk kam një orar të përcaktuar, por pasi ha mëngjesin, nisem, bëj shëtitjen time deri këtu, arrij dhe filloj përgatitjet për këto ndeshje.

- Çfarë të pëlqen më shumë nga puna jote?

- Puna ime lind nga pasioni, ndaj është e qartë që, duke qenë një pasion, më pëlqen gjithçka. Gjithçka nisi që kur luaja futboll si fëmijë dhe përpigësja të bëhesha futbollist. Pastaj ia dola dhe tani jam trajner; në këtë rast jam trajner i kombëtares. Kjo më mbush me krenari dhe, mbi të gjitha, bëj atë që më pëlqen. Nuk ka asgjë në punën time që nuk më pëlqen.

- Si është dita jote perfekte kur je i lirë?

- Siç të thashë edhe më parë, e dua shumë natyrën dhe ambientin e hapur, ndaj dua të jem gjithmonë jashtë. Varet edhe nga stina. Nëse është dimër, kërkoj vende ku ka sa më shumë borë, sepse ndoshta mund të bëj edhe ski. Shëtitjet, familja, të kaloj kohë me miqtë, janë të gjitha gjëra që më bëjnë të lumtur.

- Pas pak kohësh në Shqipëri, çfarë të ka surprizuar më shumë?

- Në fakt, nuk do të thoja se më ka surprizuar, por ka qenë një konfirmim, një konfirmim i mëtejshëm. Më kishin folur për mikpritjen tuaj dhe ju e keni tejkuluar atë që më kishin thënë. Duhet të jem i singertë: ndihem si në shtëpi, më keni bërë të ndihem si miku juaj prej gjithmonë. Për mua kjo është më shumë se një cilësi; është vërtet diçka befasuese.

- Cila është ideoja më "shqiptare" që ke mësuar?

- Nuk kam një të tillë. Dua të mësoj shumë gjëra. Tani është ende herët, sepse kam mësuar diçka dhe, nëse do të thosha tani se çfarë është, ndoshta do të gënjeja. Nuk më pëlqen të gënjej; më pëlqen të them gjërat e vërteta, ato që i ndiej vërtet.

- Çfarë të pëlqen më shumë te shqiptarët?

- Ajo që kam vlerësuar shumë gjatë këtyre muajve është vendosmëria dhe forca me të cilën i bëni gjërat. Është një vlerë shumë e madhe. Dhe është diçka që dua t'ua transmetoj edhe lojtarëve kur të vijnë, sepse kjo është ADN-ja e futbollistit dhe e popullit shqiptar.

- Ke adoptuar ndonjë zakon shqiptar?

- Jo edhe aq shumë. Po studioj për t'u afruar gjithnjë e më shumë me ju. Dalëngadalë po përpiqem të kuptoj, sepse ka shumë gjëra të bukura, shumë aspekte, edhe në territorin tuaj, që më kanë ngjallur vërtet kureshtje.

- Cila pjatë shqiptare të ka pëlqyer më shumë?

- Tavë dheu. Po, nëse e kam shqiptuar mirë... Madje është padyshim më e mirë sesa mënyra se si e shqiptova unë! Por më ka pëlqyer shumë.

- Cila është fjala jote e preferuar në shqip?

- Për nga tingëllimi, më pëlqen të them "avash-avash". Jo për ndonjë arsye të veçantë, por sepse më pëlqen si tingëllon fjala.

- Po ajo që e ke më të vështirë ta shqiptosh?

- Ndoshta sepse tek ne është shumë e lehtë të përshëndesësh me një "Ciao", ndërsa të përshëndesësh me "Përshëndetje" është pak më e komplikuar. Prandaj preferoj ta them në italisht, sepse është vërtet e vështirë në shqip.

Pastaj, versioni tjetër, "Çkemi?", sipas meje është edhe më i vështirë, kështu që për të heq dorë fare.

Artikuj te sugjeruar

SPORT 14 Shtator12:02

[Reagon Napoli, ndaj Bolognës vendos Lobotka, Allegri: Duhet të menaxhonim më mirë ndeshjen](#)

Napolit i duhej një fitore për të harruar dy humbjet radhazi në Serie A, ndaj Comos dhe Interit, si dhe...

SPORT 14 Shtator09:12

[PSG siguron fitoren e parë në Brest, falë një performance të shkëlqyer të Safonov...](#)

FRANCE - Të dielën në mbrëmje, atmosfera ishte prekëse në mbyllje të javës së katërt të ndeshjeve në...

SPORT 14 Shtator08:55

[I pafat Edon Zhegrova, dopieta e tij nuk i vlejti Juventusit. Sassuolo fiton në fund!](#)

Edon Zhegrova ishte protagonist absolut i një fundi të çmendur në transfertën e Juventusit ndaj Sassuolos, por dy golat e tij nuk m...

SPORT 14 Shtator08:27

[Kaos në Kurbin/ Vllaznia mbetet me 10 lojtarë, arbitri zbraz tribunën dhe Laçi merr 3 pikët](#)

Laçi ka mposhtur Vllazninë 2-0 në një derbi të tensionuar në Kurbin, ku ndeshja u ndërpre për shkak të incident...

SPORT 13 Shtator23:55

["Shpresojmë të jetë një fillim i mirë"/ Allegri pas fitores së Napolit: Kemi dhënë pak raste](#)

Napoli rikthehet te fitorja në kampionat. Skuadra e drejtuar nga Massimiliano Allegri mposhti Bolognan me rezultatin 1-0, duke i dhënë fund se...

SPORT 13 Shtator23:31

[Manchesterit ngjyrosen blu/ City fiton derbin me 10 lojtarë, Haaland mposht United](#)

Manchester City ka fituar derbin e Manchesterit në transfertë, duke mposhtur Manchester United 1-0 në Old Trafford. Skuadra e Enzo Maresca-s l...

SPORT 13 Shtator22:57

[Pak orë pas golit të fitores, Daniel Maldini përfshihet në aksident/ Rezultoi pozitiv në testin e alkoolit](#)

Daniel Maldini, futbollisti i Cagliarit dhe djali i legjendës së Milanit, Paolo Maldini, është përfshirë në një akside...

SPORT 13 Shtator22:49

["Çmendet" Zhegrova në fund/ Dopietë me Juventusin, por Sassuolo i prish festën](#)

Edon Zhegrova ishte protagonist i minutave të fundit në përballjen mes Sassuolos dhe Juventusit, por dopieta e tij nuk mjaftoi për të...

SPORT 13 Shtator21:27

[Tottenham në krizë me De Zerbin/ Asnjë fitore dhe asnjë gol në 4 ndeshje](#)

Tottenham po kalon një start të vështirë të sezonit, pavarësisht investimit prej rreth 300 milionë eurosh në merkaton ...

SPORT 13 Shtator21:19

[Formula 1/ Antonelli fiton edhe në Madrid, shkëputet në garën për titullin](#)

Kimi Antonelli ka fituar edhe Çmimin e Madh të Spanjës në Madrid, duke marrë fitoren e tetë të sezonit dhe duke rritur nd...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

["Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...](#)

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

["Dil jashtë", u përplas me Edi Ramën për "Terri...](#)

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

AKTUALITET 13 Shtator

[Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...](#)


Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Clevio!



Reagon Clevio!



Matilda,Piranjë jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.